

Lipjani të premtën mbetet pa qeverisje lokale

Arian Duriqi

LIPJAN, 20 QERSHOR – Të gjithë drejtorët e ekzekutivit të Lipjanit (me përjashtim të drejtorit të Bujqësisë) bashkë me dy nënkryetarët e kanë lënë Lipjanin pa qeverisje, të premtën, derisa të enjten pasdite kanë udhëtuar për një vizitë në Maqedoni.

Vetëm kryetari i kësaj komune, Imri Ahmeti, ndërkaq, të premtën është ndodhur në objektin komunal, pasi që ai nuk kishte udhëtuar me të emëruarit e tij politikë jashtë shtetit.

E vetë Ahmeti në një deklaratë dhënë KD-së e ka arsyetuar shkuarjen e Ekzekutivit në Maqedoni. Kryetari i Lipjanit e ka konfirmuar se të emëruarit e tij politikë e kanë humbur tashmë një ditë pune.

"Ekzekutivi është në një trajnim lidhur me çështjet protokollare dhe komunikimit të brendshëm financiar nga një projekt i MAPL-së, ndërsa e kanë humbur vetëm një ditë pune. Ndërsa unë dhe drejtori i Bujqësisë Feti Krasniqi kemi mbetur këtu", ka deklaruar Ahmeti.

Ndërkohë që, reagim të menjëherëshëm për këtë rast, ka pasur nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në YAHR ka thënë se organizata që drejton shpreh shqetësimin e madh për mbetjen e Komunes pa qeverisje lokale.

"Është e evidente se të premtën më 20



qershor 2014 Komuna e Lipjanit ka mbetur pa qeverisje lokale. Është për t'u çuditur fakti se si komplet stafi politik i Ekzekutivit të Komunes së Lipjanit duke përfshirë dy nënkryetarët dhe të gjithë drejtorët e drejtorive komunale nuk janë në vendet e tyre të punës, pasi që janë të gjithë për një vizitë në Maqedoni", është shprehur ai.

Për më tepër, Krasniqi, ka shtuar se të premtën ai e ka pasur të pamundur të vë kontakt zyrtar me përgjegjësit e menaxhimit të Komunes.

"Është shqetësuese se si Komuna mundet me mbet pa qeverisje të institucioneve lokale, kjo pasi që të premtën ka qenë e pamundur që të kontaktohet me dikë që do të jetë

përgjegjës për menaxhimin e institucionit të ekzekutivit apo të legjislativit. Një gjë e tillë pritet të jetë deri të hënën", ka thënë ai.

Një situatë të tillë e ka kritikuar edhe opozita në këtë komunë. Lulzim Rrustemi, nënkryetar i PDK-së, Dega e Lipjanit, ka deklaruar me këtë rast se Lipjanin pa qeverisje lokale po e lënë pikërisht ata që sipas tij është dëshmuar se nuk kanë përgjegjësimëri në punë.

"Serioziteti në qeverisje matet edhe me këso rastesh. Dhe, nuk mund të imagjinohet një ditë pune në Komunë pa komplet ekzekutivin dhe kjo është për çdo kritikë", ka thënë ai.

©KOHA Ditore



ADVANCED

ro
3 r
sy
fu
qy
të
jar
fu
Kr
Zv
Ha
re
ba
Qe
Kc
fr
Ar
Gj
m
i
pë
let
pr
pë
uj
uj
M
sj
nj
Q
ve
se
ec